R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 3009 prot. Tiranë, më 19.10.2026

REKOMANDIM

Nr. 61, datë 19.10.2026

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS TË AUTORITETIT PUBLIK "INSTITUTI I INTEGRIMIT TË ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIKË"

Në mbështetje të neneve 4, 6 dhe 7, si dhe shkronjës "f" të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar (në vijim LDI),

KONSTATOHET SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") është përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e transparencës proaktive të autoriteteve publike. Në kuadër të ushtrimit të kësaj kompetence, vlerësohet se Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë, si institucion publik që ka për qëllim marrjen e masave dhe ndjekjen e çështjeve që lidhen me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, përbën një kategori të rëndësishme të autoriteteve publike.

Në pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të ndryshuar, parashikohet: *"Institucionet e varësisë mund krijohen për të kryer ato funksione administrative, të përcaktuara, Brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore, kryerja e të cilave kërkon shkallë të lartë specializimi në menaxhim apo drejtim dhe kanë të bëjnë me zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit, ofrimin e shërbimeve publike për popullatën apo shërbimeve të brendshme për administratën shtetërore ose mbështetje e këshillim për ministrinë".*

Nëpërmjet ligjit nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", të ndryshuar, është vendosur krijimi dhe funksionimi i Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë, i cili ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.

Me Vendimin nr. 515, datë 25.09.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale", Këshilli i Ministrave ka përcaktuar fushat e përgjegjësisë shtetërore të kësaj ministrie. Konkretisht, në pikën 3, shkronja "g", të këtij Vendimi, përfshihet edhe marrja e masave dhe ndjekja e çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.

Sa më sipër, Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Në pikën 1 të nenit 2 të LDI-së përcaktohet se: *""*Autoritet publik*" a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare, ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike"*.

Për sa më sipër, Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë konsiderohet autoritet publik, në kuptim të LDI-së.

Autoritetet publike, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të LDI-së, kanë detyrimin të vënë në zbatim Programin Institucional të Transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë, si dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Gjithashtu, në pikat 2 dhe 3 të këtij neni përcaktohet se: *"2. Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut, dhe sidomos:*

a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

3. Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik".

Programi i Transparencës vlerësohet si instrument konkret, përmes të cilit autoriteti publik ndërton dhe rrit transparencën institucionale nëpërmjet publikimit dhe përditësimit të vazhdueshëm me informacion në rubrikat e tij.

Në nenin 6 të LDI-së parashikohet se: *"Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi..."*.

Në zbatim të shkronjës "c" të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 6 të LDI-së, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Urdhrin nr. 280,

datë 30.12.2025 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për autoritetet publike” (në vijim “Urdhri nr. 280/2025”), publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 6, datë 08.01.2026. Në përputhje me pikën 3 të këtij Urdhri, autoritetet publike kishin detyrimin për zbatimin e Programit Institucional të Transparencës, sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur urdhrit, jo më vonë se data 31.03.2026.

Në këtë kuadër, autoritetet publike kanë detyrimin të përshtatin Programin Institucional të Transparencës me modelin e miratuar, si dhe të garantojnë publikimin dhe përditësimin e kategorive të informacionit që bëhen publike pa kërkesë, në përputhje me nenin 7 të LDI-së.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve ligjore të mësipërme, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin *online* të faqes zyrtare të internetit të Autoritetit Publik. Nga monitorimi i kryer, Zyra e Komisionerit konstatoi se Autoriteti Publik ka publikuar Programin e Transparencës, por jo në përputhje me përmbajtjen e miratuar me Urdhrin nr. 280/2025. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit konstatoi se nuk janë plotësuar dhe përditësuar me informacion të gjitha rubrikat në Programin e Transparencës, konkretisht:

Rreth Autoritetit

- Struktura organizative/organigrama;
- Struktura e pagave;
- Funksionet dhe detyrat e autoritetit publik;
- CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë edhe anëtarët e kabinetit të titullarit të autoritetit publik, përshkrimi i procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre;
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të autoritetit publik për të marrë vendime;
- Vendimmarrja e autoritetit publik;
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik (*përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave, afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve*).

Shënim: Nëse autoriteti publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krah të çdo pike.

Kuadri ligjor rregullator dhe integrimi evropian

- Legjislacion ndërkombëtar;
- Informacion mbi procesin e integrimit evropian;
- Dokumente strategjike për integrimin evropian;
- Raportime mbi zbatimin e detyrimeve në procesin e integrimit evropian;
- Raporte monitorimi, auditimi dhe vlerësimi nga ana e Komisionit Evropian (*p.sh. progresraporti etj.*);
- Dokumente të tjera mbi procesin e integrimit evropian;
- Kodi i sjelljes;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit;

- Strategji;
- Raport vjetor;
- Manuale/dokumente politikash, që kanë lidhje me funksionet e autoritetit publik dhe që prekin publikun.

Shënim: Nëse autoriteti publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krah të çdo pike.

E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

- Koordinatori/emri mbiemri;
- *Email*;
- Numri i gjelbër;
- Tel;
- Adresa;
- Orari;
- Format kërkese/shpjeguese (*hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim*);
- Format ankese/shpjeguese (*procedura e ankimit te Komisioneri*).

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi autoritetin publik

- Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë;
- Planet strategjike të punës;
- Raporte monitorimi/auditimi (*p.sh. KLSH*);
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit publik.

Shënim: Nëse autoriteti publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krah të çdo pike.

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të autoritetit publik

- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (*sipas viteve*);
- Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (*sipas viteve*);
- Donacione, sponsorizime (*sipas viteve*);
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

Shënim: Nëse autoriteti publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krah të çdo pike.

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik privat

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve);
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik;
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik;

- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

Shënim: Nëse autoriteti publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimi (nuk ka informacion) në krah të çdo pike.

Shërbimet që ofrohen nga autoriteti publik

- Lista e shërbimeve që ofron autoriteti publik, përfshirë tarifat, formularin e aplikimit, afatin kohor, procedurën e ankimimit, standardet për cilësinë e shërbimit.

Shënim: Të vendoset shënimi nëse autoriteti publik nuk ofron shërbime.

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik

- Njoftimi dhe konsultimi publik;
- Planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes;
- Komente/rekomandime/opinione të palëve të interesuara/grupe interesi;
- Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve;
- Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes;
- Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- Emër/mbiemër të koordinatorit për konsultimin publik, adresë postare/elektronike.

Shënim: Të vendoset shënimi nëse autoriteti publik nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore/nënligjore.

Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

- Lista e dokumenteve që administrohen nga autoriteti publik me afatet e ruajtjes;
- Forma e dokumenteve/informacioneve (*elektronik*, *kopje fizike*, *audio*, *video*, *foto*).

Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga autoriteti publik

- Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik;
- Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve;
- Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim;
- Procedura e ankimimit.

Shënim: Të vendoset shënimi nëse autoriteti publik nuk e ofron këtë shërbim.

Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga autoriteti publik

- Njoftime të ndryshme;
- Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil;
- Raporte;
- Publikime;

- Statistika;
- Projekte;
- Bashkëpunime etj.

Shënim: Autoriteti publik vlerëson publikimin duke pasur parasysh kërkesat që merr më shpesh.

Nga ana tjetër, pika 1 e nenit 10 të LDI-së përcakton se: *"1. Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik i njofton Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit".*

Në pikën 1 të nenit 8 të LDI-së parashikohet se: "*Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.* ***Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj*** *dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër".*

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të pasur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përfaqësojnë instrumentet kryesore të promovimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut, si rrjedhojë çdo autoritet publik ka detyrimin ligjor për vënien në zbatim dhe përditësimin e vazhdueshëm me informacion të tyre.

Për zbatimin e Programit Model të Transparencës, Autoriteti Publik mund t'i referohet Urdhrit nr. 280/2025 dhe dokumentacionit përkatës të publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit, në adresën https://idp.al/ap25/.

Nga sa më sipër, rezulton se Programi i Transparencës i Autoritetit Publik nuk është përshtatur plotësisht me modelin e miratuar me Urdhrin nr. 280/2025 të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe paraqet mangësi në publikimin dhe përditësimin e kategorive të informacionit që duhet të bëhen publike pa kërkesë, në përputhje me nenin 7 të LDI-së.

Në këto kushte, vlerësohet e nevojshme marrja e masave nga Autoriteti Publik për përputhjen e Programit Institucional të Transparencës me kërkesat e legjislacionit në fuqi, me qëllim garantimin e aksesit të publikut në informacion të plotë, të saktë, të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 dhe 8, shkronjës "f" të pikës 2 të nenit 9/1, shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 10 dhe pikës 1 të nenit 24/1 të LDI-së, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Autoriteti Publik “Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë” të përditësojë dhe të ndërlidhë në Programin e Transparencës të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshme për t’u bërë publike, në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, dhe Urdhrin nr. 280, datë 30.12.2025 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për autoritetet publike”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik “Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë” të përditësojë jo më pak se 1 (një) herë në muaj Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, në përmbushje të detyrimeve të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 10 dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.

3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 24/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi të plotësohen brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni.

4. Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas neneve 18 dhe 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 19.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi